



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



NDIHMJA JURIDIKE | PRAVNA POMOC
LEGAL AID

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas
Agencija za Besplatnu Pravnu Pomoć
Agency for Free Legal Aid

KËSHILLI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

ANJF-2013/5

RREGULLORE

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR OFRIMIT E NDIHMËS JURIDIKE FALAS NGA
OJQ-TË**

Në përputhje me dispozitat e nenit 30, të Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, Këshilli për Ndihmën Juridike Falas, në takimin e mbajtur me 01.03.2013,

Nxjerr:

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS NGA OJQ-TË

Neni 1

Qëllimi kryesor i nxjerrjes se kësaj Rregulloreje është rregullimi dhe përcaktimi i procedurave të punës, për kriteret e ofrimit të ndihmës juridike Falas nga OJQ-të të cilat hyjnë në partneritet me Agjencinë për Ndihmën Juridike Falas.

Neni 2

Këshilli i Ndihmës Juridike Falas, në media, shpall thirrjen publike për hyrje në partneritet të OJQ-ve me ANJF, për ofrimin e shërbimeve juridike të autorizuara në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Këshilli, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 3

OJQ-të aplikojnë me projekt në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 4

Këshilli i Ndihmës Juridike, aprovon Projektin për financimin e OJQ-ve, për ofrimin e shërbimeve juridike falas.

Neni 5

OJQ-tëtë cila hyjnë në partneritet me ANJF-në duhet t'i posedojnë të gjitha dokumentet e parapara me Ligjin për regjistrimin e OJQ-ve, dhe një kopje të certifikatës për regjistriminë saj, të lëshuar nga organi kompetentë, dhe t'ia dorëzojë ANJF-së.

Neni 6

OJQ-të partnere e ANJF-së duhet të punojë në pajtim me Ligjin nr. 04/L 017 për Ndihmë Juridike Falas dhe aktet nënligjore për ofrimin e ndihmës juridike falas të ANJF-së.

Neni 7

OJQ-të kanë për detyrë ofrimin e ndihmës juridike falas në lëmin Civile, Administrative, Kundërvajtje dhe Penale, për qytetarët me gjendje të vështirë ekonomike.

Neni 8

Pagesat bëhen në këste mujore sipas buxhetit mujor të prezantuar në projektin e aprovuar, pas dorëzimit të raporteve për shërbimet e ofruara juridike falas.

Neni 9

Ofrimi i ndihmës juridike për qytetarët përfshinë:

- ofrimi i informacioneve,
- ofrimi i këshillave juridike,
- përpilimi i shkresave

Neni 10

OJQ-ja është e obliguar që të raportojë për punën e saj, pranë ANJF-së, përmes raporteve mujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

Neni 11

Obligimet dhe të drejtat e Agjencisë për Ndihmës Juridike Falas dhe OJQ-së do të ceken në kontratën e cila do të lidhet në mes të ANJF-së dhe OJQ-së, në pajtim me Legjislacionin në fuqi.

Neni 12

10.1 Kontrata për shërbime juridike falas, mund të shkëputet nga cila do palë kontraktuese, në rast të shkeljeve të dispozitave kontraktuese.

10.2 Në rast të shkëputjessë kontratës duhet të bëhet një njoftim paraprak, në afat prej 1 muaji, prej momentit të marrjes së vendimit për shkëputje të kontratës.

Neni 13

Në rast të keqpërdorimit apo mashtrimit lidhur me fondet që duhet të shfrytëzohen për nevoja të projektit, palët kontraktuese kanë të drejtë të iniciojnë procedurën pranë gjykatës kompetente.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit për Ndihmën Juridike Falas.

Më: 12.03. 2013

Kryesues i Këshillit

Alban Sutaj